

**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU**

V2024053950191842179

DATE 25/04/2024
NR REP 3131

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Në Tirane, sot, me date 25/04/2024 përpara meje Noter Julian Zhelegu, Noter i Dhomës së Noterëve Tiranë, në adresën Rr. Pjeter Bogdani, nr. 13, K. I, Tiranë, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT:

Erisa Hysaj, atësia Asim, amësia Ema, shtetase Shqiptare, lindur në Pac, Tropojë dhe banues në Tropojë, me adresë Pac Tropoje; Bytyç; 0000; Tropojë, lindur më 18/05/2000, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033520880 dhe nr. personal K05518034R,

E cila me kerkoi te vertetoj dokumentin e njejte me origjinalin :Vendim per Leshimin e Deshmise se Trashegimise Ligjore me Nr 140 Rep dhe Nr 64 Kol i dates 09.04.2024,

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjës në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.


Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULIAN ZHELEGU



A large, stylized handwritten signature in blue ink, which appears to be 'J. Zhelegu', is written over the notary stamp and extends across the page.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË


NOTER ALFRED J. VASIL
ADRESA NR.10, BLV "GJERGJ
FISHTA", NR.88, NR.1, NR.1
TEL: 672018025

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 140

Nr. koleksioni: 64

Tirane më 09/04/2024



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024051320007996284



LËSHIMI I DËSHMISË
SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot, më datë 09 të muajit Prill të vitit dymijë e njezet e kater, une Noter ALFRED J. VASIL, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tirane, me zyrë në adresën Blv" Gjergj Fishta", Pallati E-88, kati i dyte, zyra Nr.1, mora në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga:

KËRKUESE: Aida Bushati, atësia Aleksander, amësia Veneranda, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banuese po në Tirane, me adresë Rr. Mehmet Brocaj; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; lindur më 06/01/1972, gjendja civile "beqare", madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. personal H25116043Q.

OBJEKTI: Leshim deshmi trashëgimie ligjore për të ndjeren Veneranda Bushati, atësia Kol, amësia Marija, datelindja 27.01.1941, nderruar jete me 04.01.2024.

BAZA LIGJORE: Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

VËREJ SE:

Kërkuesja, Aida Bushati, datë 02.03.2024 ka paraqitur një kerkese para meje noterit me objekt: "Leshim deshmi trashëgimie për trashëgimlenses Veneranda Bushati, perkatesisht nena e saj. Pasi analizova bazueshmerine në ligj e në prova të kësaj kerkese dhe kompetencën lëndore e tokësore, konstatova se ajo ka interes të ligjshëm për sa më sipër, pra legjitimohet për të përfituar të drejta dhe detyrime juridiko-civile. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se: E ndjera Veneranda Bushati, atësia Kol, amësia Marija, ka nderruar jete me 04.01.2024, fakt ky që vërtetohet sipas certifikate vdekje, akti i vdekjes nr. 4 datë 08.01.2024, certifikate vdekje datë 11.03.2024, leshuar prej Njësia Administrative Nr.9/Tirane, nxjerre e vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile. Sipas certifikate martesë (nga akti), data e lidhjes së martesës Akti nr.572 datë 28.10.1965, leshuar prej Bashkia Tirane, datë 29.03.2024, certifikate e trungut familjar (bashkëngjitur), rezultoi që trashëgimlensesja, e ndjera Veneranda Bushati, mbiemri i vajzërisë Kurbini, ka qenë martuar ligjërisht me shtetasin Aleksander Bushati, i biri i Kol e Sevasti Bushati dhe nga kjo martesë kanë sjelle në jete dy femije: djalin Albens Bushati, i biri i Aleksander e Veneranda Bushati, i datelindjes 21.05.1967, certifikate personale nxjere prej Njësia Administrative Nr. 9/ Tirane, vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile, datë 03.04.2024 dhe vajzën Aida Bushati, e bija e Aleksander e Veneranda Bushati, e datelindjes 16.01.1972, certifikate personale nxjerre prej Njësia Administrative Nr. 9/ Tirane, datë 11.03.2024, vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile.

Nga dokumentet e gjendjes civile bashkëngjitur rezultoi që e ndjera ka lënë pas dy femijet përmendur më sipër.

Në nenin 361 të Kodit Civil parashikohet se "Në radhë të parë thirren në trashëgim femijet dhe bashkëshorti i aftë ose i pa aftë për punë, duke trashëguar sejcili në pjesë të barabarta". Bazuar në këto dispozite vërejt se, personat që do të thirren si trashëgimtare ligjore të radhës së parë janë dy femijet e saj Albens Bushati dhe Aida Bushati. Nuk rezultoi që e ndjera Veneranda Bushati të ketë pasur femije të lindur jashtë martesë apo të ketë lënë testament. Kjo e fundit vërtetohet edhe nga Kthimë pergjigje kerkese nr. 1190-61 datë 08.04.2024, leshuar prej Dhoma Kombëtare e Noterisë Tirane, bashkëngjitur. Kërkuesja, sqaroi se asnjë nga trashëgimtarët e radhës së parë të identifikuar

si me sipër nuk janë përjashtuar nga trashëgimia. Gjithashtu ajo shpjegoi se e ndjera, nena e saj, nuk ka pasur ne ngarkim persona te paafte per pune dhe nuk rezultojne rrethana padenjesie. Kerkuesja me kerkoi pranimin e kerkeses dhe te vendoset sipas objektit te saj.

Për të zgjidhur sa me sipër, une noteri i referohem nenit 318 të Kodit Civil, i cili parashikon se: Trashëgimia celet ne kohën kur vdes trashëgimlensesi dhe ne vendin ku ai ka pasur banimin e tij te fundit dhe rregullohet sipas ligjit te kohes se çeljes së trashëgimisë.

Per te perforcuar perfundimin e mesiperme, na ndihmon interpretimi logjik dhe sistematik dispozitive ligjore . Keshtu modeli juridik i zgjedhur nga Legjislatori per regjimin juridik te maredhenies se trashëgimise eshte sistemi i fitimit te trashëgimit shprehur ne nenin 330 i Kodit Civil sipas te cilit, "trashëgimia fitohet me vdekjen e trashëgimlensetit". Pra vdekja e trashëgimlensetit , e cila perkon me kohën e çeljes se trashëgimise do te percaktoje menyren se si do te realizohet trashëgimia duke arritur ne perfundimin se ky rregullim do te behet sipas ligjit civil qe eshte ne fuqi ne kohën e vdekjes. Ky eshte momenti per te vendosur lidhur me trashëgimtarete e gjalle , duke percaktuar rrethin e tyre, pjesen, te drejtat dhe detyrimet e pasurise se trashëgimlensetit. Une noteri konstatoj se trashëgimlensesia, sipas certifikates se vdekjes ka nderruar jete me 04.01.2024, e rrjedhimisht ky eshte moment i celjes se trashëgimise dhe moment qe percakton ligji veprues ne kohe, i cili eshte Kodi Civil ne fuqi.

Ne kete menyre, une noteri cmoj se kerkesa e kerkuseses eshte e bazuar ne ligj e ne prova dhe si e tille pranohet prej meje, duke njohur si trashëgimtarete ligjore te trashëgimlenseses Veneranda Kol Bushati, ne pjese te barabarta dhe ideale prej 1/2 (nje e dyta) e pasurise trashëgimore te luajtshme e te paluajtshme secilin nga trashëgimtarete e lartepemendur.

Sipas nenit 331 te Kodit Civil, i cili shprehet se: Me celjen e trashëgimit i kalon edhe posedimi i trashëgimlensetit mbi pasurine trashëgimore, pa qene nevoja per te vene dore mbi ate, trashëgimtarete e identifikuar ne kete akt ligjor , konsiderohen automalakisht posedues te pasurise objekt trashëgimie sipas pjeseve te tyre respektive , pavaresisht nga sundimi efektiv apo venia dore fizikisht mbi te.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet: 316, 317, 318, 320, 348, 360 e vijues të Kodit Civil, dhe neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për noterinë";

V E N D O S A:

Pranimin e kerkeses.

Leshimin e deshmise se trashëgimise ligjore per te ndjeren Veneranda Bushati, duke caktuar si trashëgimtarete ligjore te rradhes se pare:

1- Albens Bushati, i biri , atesia Aleksander, amesia Veneranda, i datelindjes 21.05.1967, mban dokument identifikimi nr. personal G70521048S.

2- Aida Bushati, e bija, atesia Aleksander, amesia Veneranda, e datelindjes 16.01.1972, mban dokument identifikimi nr. personal H25116043Q, te cilet trashëgojne nga 1/2 pjese takuese secili ne pasurine e luajtshme e te paluajtshme e kudondodhur te trashëgimlenseses se mesiperme si dhe detyrimet perkatese.

Kërkuesja mori dijëni dhe iu sqarua nga Noteri detyrimi ligjor për depozitim të dëshmisë së trashëgimisë ligjore në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë ditë kalendarike), nga data e lëshimit të saj. Në rast të kundërt, për çdo ditë vonëse, aplikohen penalitetet përkatëse sipas dispozitive ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 "Për Kadastrën".

Shpenzimet Noteriale i ngarkohen kërkueses.



Kjo dëshmi trashëgimie përbëhet nga 3 (tre) fletë dhe lëshohet në kopje origjinale nga të cilët, njëri depozitohet në arkivin e zyrës noteriale, nga një kopje i dorëzohet kërkueses për ta paraqitur në institucionet përkatëse (për aq pàsuri sa disponon) dhe nga një kopje u jepet trashëgimtarëve ligjorë.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet në Tirane, sot më datë 09.04.2024.

NOTER

ALFRED J. VASIL

Alfred Vasil

